



Rregullorja per regjistrimin dhe mbajtjen e regjistrit te anetareve.

Rregullorja per regjistrimin e KM dhe kandidateve per KM antare te Instiututi te Kontabilisteve te Miratuar si dhe mbajtja e regjistrit te antareve hartohet ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 “ Per Auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar“ i ndryshuar.

Neni 1 **Regjistrimi i KM**

Ne regjistrin e publikushem te Institutit te Kontabilisteve te Miratuar jane te regjistruar te gjithë ata persona te cilet plotesojne kerkesat e percaktuara ne piken 9 te nenit 2 te ligjit nr.10091 dt 05.03.2009 i ndryshuar.

Per te bere te mundur regjistrimin dhe publikimin e emrit ne regjistrin e publikueshem te IKM, çdo Kontabilist i Miratuar fillimisht duhet te antaresohet prane Institutit dhe duhet te plotesoje disa dokumenta qe shoqerojen kete antaresim.

Dokumentat qe duhet te paraqes nje KM per antaresimin ne IKM jane:

- Kerkese me shkrim per antaresim drejtuar komisionit te regjistrimit e cila plotesohet sipas nje formati te parashtypur e te miratuar nga KD i IKM.
- Certificate ose vertetim i provimit te leshuar nga Autoriteti Certifikimit sot (KPAP) per marjen e titullit Kontabel i Miratuar.Ne rastin e regjistrimit te nje shoqerie KM duhet te paraqitet ky vertetim per administratorin ose ortaket KM te shoqerise.
- Kopje te passaportes ose kartes se identitetit ID. Ne rastin e shoqerise KM nje kopje e statutit te shoqerise.
- Kopje te diplomes te shkolles se larte sipas percaktimit te bere germen Ç te pikes 1 te nenit 16 te ligjit nr. 10091 dt.05.03.09 i ndryshuar. Ne rastin e nje shoqerie KM duhet te paraqitet diploma e administratorit ose ortakeve te shoqerise
- Vertetim nga organet e drejtesise qe nuk ka qene i denuar per vepra te cilat jane te lidhura me aktivitetin si KM ose si shoqeri KM.
- Nje CV personale. Ne rastine e shoqerise KM duhet nje CV e ortakeve KM dhe nje CV e shoqerise.
- 2 fotografi te madhesise 4x6. Per shoqerite KM fotografit te jene te administratorit kur eshte KM ose te ortakeve KM.
- Pagesa e kuotes fikse vjetore te antaresimit

Neni 2

Regjistrimi i kandidateve per KM

Cdo person fizik i cili ploteson kerkesat e germave a,b, te pikes 1 te nenit 49 te ligjit nr.10091 dt. 05.03.09 “ Per Auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar“ ka te drejte te regjistrohet si kandidate per KM ne Institutin e Kontabilisteve te Miratuar.

Per regjistrimin e tij si kandidate personi fizik duhet paraqes dokumentat e me poshtem:

- Kerkese me shkrim per antaresim drejtuar komisionit te regjistrimit e cila plotesohet sipas nje formati te parashtypur e te miratuar nga KD i IKM.
- Kopje te passaportes ose kartes se identitetit ID.
- Kopje te diplomes te shkolles se larte.
- Vertetim nga organet e drejtesise qe nuk ka qene i denuar per vepra te cilat jane te lidhura me aktivitetin ne fushen e profesionit.
- Nje CV personale
- 2 fotografi te madhesise 4x6
- Pagesa e kuotes fikse vjetore te antaresimit

Neni 3

Depozitimi Dokumentacionit te regjistrimit

Kontabilistet e Miratuar, shoqerite KM dhe te gjithe personat fizik te cilet duan te antaresohen ne IKM duhet qe dokumentacionin e nevojshem per regjistrim te pershkruar ne nenet 1 dhe 2 te kesaj rregullore, duhet ta paraqesin ne degen/seksionin e rrethit ku zhvillojne aktivitetin ose ne zyren qendrore ne Tirane.

Per rastet kur dokumentacioni depozitohet ne dege/seksione, organet drejtuese te deges/seksionit origjinalin e dokumentacionit e nisin ne zyren qendrore brenda 10 diteve nga data e depozitimit. Kryesite e Degeve/Seksioneve arshivojne nje kopje dokumentacionit te regjistrimit ne zyren e tyre.

Neni 4

Komisioni i Regjistrimit

Komisioni i Regjistrimit eshte autoriteti i cili miraton regjistrimin e KM ne regjistrin e publikushem te IKM te antareve KM, shoqerive KM si dhe regjistrimin e kandidateve te cilet do ti nenshtrohen testimit per te mare titullin KM.

Komisioni i Regjistrimit emerohet nga Keshilli i Drejtimit i IKM. Ai perbehet nga tre persona.

Komisioni i Regjistrimit brenda 10 diteve nga marja e dokumentacionit te depozituar nga KM, shoqerite KM dhe kandidatet per KM bene shqyrtimin e tij dhe mere vendimin per pranimin ose jo te kerseses se paraqitur, njekohesisht njofton personin e interesuar per vendimin e mare.

Per rastet kur KM, shoqeria KM ose kandidati per KM ka mangesi ne dokumentacionin e kerkuar per regjistrim, Komisioni i Regjistrimit e njofton personin dhe i le nje afate prej 10 ditesh per plotesimin e tyre .

Komisioni i Regjistrimit miraton dhe urdheron berjen te gjitha ndryshimet e tjera ne regjistrin e publikueshem te IKM te cilat lidhen me:

- Kalimin nga seksioni persona fizik apo shoqeri KM aktive ne jo aktive dhe anasjelltas
- Kalimin nga seksioni i kandidateve ne ate te anetarve aktiv ose jo aktiv pas certifikimit te tyre si KM
- Kalimin e personave fizik ne shoqeri te kontabilistev te miratuar dhe anasjelltas

Komisioni i Regjistrimit cdo date 5 te muajit pasardhes i dorezon Drejtimit Ekzekutiv listen me regjistrimet e reja dhe urdherin per ndryshimet qe duhet te behen ne regjistrin e publikueshem.

E drejta e antaresimit pas miratimit nga Komisioni Regjistrimit, fillon nga data e kerkeses per regjistrim.

Neni 5 Regjistri i Antareve

Ne perputhje me kerkesat e pikes 2 te nenit 51 te ligjit nr.10091 date 05.03.2009 i ndryshuar, IKM pergatit regjistrin e publikueshem te antareve te tij te cilet jane KM, shoqeri ose kandidate per KM. Regjistri mbahet ne forme elektronike dhe dokumentare, ai eshte i ndare ne kater seksione dhe perkatesisht:

- a. Antare KM, persona fizike aktive.
- b. Antare KM, persona fizike joaktive (pasive).
- c. Kandidate per KM
- d. Shoqeri te Kontabilistev te Miratuar

Ne perputhje me ndarjet e bera ne ligje, IKM ka percaktuar edhe se kush persona fizik do te perfshihen ne keto ndarje (seksione).

- **Antare KM, persona fizik aktive** perfshine ata antare te cilet:
 1. Kane certifikate si Kontabel i Miratuar ose kane vertetimin e dhenies se provimeve per KM sipas ligjit.
 2. Ushtrojen aktivitet si te pavarur dhe jane regjistruar ne organet tatimore
 3. Jane punesuar si Kontabel i Miratuar me kontrate individuale pune me kohe te plote ose te pjesshme.

- **Antare KM, persona fizik joaktive** perfshine ata antare te cilet
 1. Kane certifikate si Kontabel i Miratuar
 2. Nuk ushtrojne aktivite dhe nuk jane te regjistruar ne organet tatimore
 3. Jane te punesuar ne sektore publik
 4. Jane te punesuar por qe nuk ushtrojne aktivitet si Kontabel te Miratuar

- **Antare Kandidate per KM** jane te gjitha ata persona te cilet plotesojne kerkesat e germave a,b dhe ç pikes 1 te nenit 16 te ligjit nr. 10091 date 05.03.09 “ Per Auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar“ i ndryshuar dhe jane antaresuar ne IKM.

- **Shoqeri te Kontabilisteve te Miratuar** jane te gjitha ato shoqeri te cilat jane regjistruar ne organet tatimore sipas kerkesave te ligjit “ Per tregtaret dhe shoqerit tregtare“.

Regjistri i publikushem ne seksionin e **Antare KM persona fizik aktiv** do te permbaje disa informacione te organizuara ne kolona te veçanta si vijon:

Numrin e identifikimit personal (Nr regjistrin), Nr e deshmise te KM ose te vertetimit te porvimeve per KM, te dhenat personale te secilit prej antareve KM te IKM, pikat e kontaktit dhe shenime te ndryshme qe kane te bejone me masat disiplinore te mara ndaj KM per shkeljet e konstatuara gjate aktivitetit te tij.

| Nr Regjistrin | Emri Mbiemri | Nr Certifikates ose Vertitimi nga autoriteti i Certifikimit | Adresa Personale | Telefoni | E - Mail | Shenime |
|---------------|--------------|---|------------------|----------|----------|---------|
|---------------|--------------|---|------------------|----------|----------|---------|

Regjistri i publikushem ne seksionin e **Antare KM persona fizik joaktiv (pasive)** do te permbaje: numrin e identifikimit personal (Nr regjistrin), Nr e deshmise te KM ose te vertetimit te porvimeve per KM, te dhenat personale te secilit prej antareve, pikat e kontaktit dhe shenime te ndryshme qe kane te bejone me arsyen pse KM ka kaluar ne kete seksion.

| Nr Regjistrin | Emri Mbiemri | Nr Certifikates ose Vertitimi nga autoriteti i Certifikimit | Adresa Personale | Telefoni | E - Mail | Shenime |
|---------------|--------------|---|------------------|----------|----------|---------|
|---------------|--------------|---|------------------|----------|----------|---------|

Seksioni i trete ne te cilen jane regjistruar **kandidatet per KM** do te permbaje: Numrin e regjistrit, te dhenat personale te kandidatit, daten e kerkeses per regjistrim, pikat e kontaktit dhe te dhena per kryerjen e trajnimit ne SKK.

| Numri Regjistrit | Emri Mbiemri | Data e kerkeses per regjistrim | Adresa Personale | Telefoni | E-mail | Trajnimi ne SKK | |
|------------------|--------------|--------------------------------|------------------|----------|--------|-----------------|---------------------|
| | | | | | | Nr certifikates | data e certifikates |

Seksioni katert **Shoqeri te Kontabilistev te Miratuar** do te permbaje: Numrin e regjistrit, emrin e shoqerise, adresa e aktivitetit, emri adminstratorit, pikat e kontaktit dhe numrin e KM te punsuar ne kete shoqeri.

| Numri Regjistrit | Emri Shoqerise | Adresa e aktivitetit | Emri i administratorit | Telefoni | E - Mail | Numri KM te punesuar |
|------------------|----------------|----------------------|------------------------|----------|----------|----------------------|
|------------------|----------------|----------------------|------------------------|----------|----------|----------------------|

Numri i regjistrit te antarit te IKM eshte i pandryshueshem. Ne rast c' regjistrimi per shkak perjashtimi ose largimi vullnetar, ai nuk i jepet ne perdorim ndonje personi tjetër. Ne kolonen „shenime“ behet shenimi i dates se largimit dhe c' regjistrimit nga regjistri i IKM.

Keshilli i Drejtimit informohet ne çdo mbledhje te radhes se tij nga komisioni i regjistrimit ne lidhje me situaten e antaresise dhe regjistrimet e ç' regjistrimet ne regjistrin e publikueshem.

Keshilli i Drejtimit miraton listen perfundimtare nje here ne çdo tre muaj te anatreve te IKM dhe ja dergone ate per informacion institucioneve dhe organeve te interesuara (BMP, QKB, Tatime, Gjykata etj).

Neni 6

Drejtori ekzekutiv dhe stafi qe ka ne vartesi eshte pergjegjes per publikimin ne faqen e internetit te IKM te regjistrit te publikueshem te antareve. Mbi bazen e te dhenave te mara nga Komisioni i Regjistrimit bene perditesimin te pakten njehere ne muaj te regjistrit te publikueshem me ndryshimet ne antaresi.

Regullorja eshte rishikuar ne perputhje me kerkesat e Ligjit 10091 05.03.2009 i ndryshuar me ligjin 47/2016

Kryetari i Keshillit te Drejtimit

Prof.Dr. Sotiraq DHAMO